

Në regjistrat e botuar të Universitetit të Padovës me shënimet e shekullit XVI, është një listim "1567... Ioannes Busichio de Civitali Fori Iulii." Në këtë vit, më 6 prill, do të ketë bërë kërkesën për mbrotje të doktoraturës njëfarë Ioannes Busichio në Padovë. Mbi këtë temë dhe ca çështje të tjera që lidhen me Mesharin do të ndajmë për lexuesin e ExLibris një fragment nga libri *Tipografia shqiptare 1555-1912* që rishtazi është promovuar në Prishtinë e Tiranë. Kërkimi që trajton kryesisht problematikën e shtypshkronjave, tipshkronjave dhe alfabetëve shqiptare një pjesë të mirë të vëmendjes ia kushton edhe *Mesharit* të Gjon Buzukut.

NJË GJON BUZUK NGA FRIULI, DOKTORANT NË PADOVË NË VITIN 1567

Nga Yll Rugova

(fq. 6)

Me rastin e 151 vjetorit të lindjes së Poetit
**“NDAHEN ÇMIMET
“ATË GJERGJ FISHTA”
NË LEZHË**

(fq. 5)

SHËNIME MBI LIBRAT

vështrim krahasues

**“PALLATI I ËNDRRAVE”
TË KADARESË DHE
“METAMORFOZAT” E OVIDIT**

Nga Ahmet Mehmeti (fq. 4)

Mid'hat Frashëri *Vepra të Zgjedhura*, vëllimi 7

**MID'HAT FRASHËRI-
MBROJTËS I MADH I
ÇËSHTJES ÇAME**

Prof. Dr. Bashkim Kuçuku (fq. 12)

Mbi romanin “Amerikani” të Odise Kotes, Toena

**ROMANI “AMERIKANI” - NJË
RISHFAQJE E BEFTË E MITIT TË
ORFEUT NË KOHËT MODERNE**

nga Zija Vukaj (fq. 13)


**ROMANET E
GËZIM ALIUT**

Nga Mërgim Bekteshi (fq. 10)

Mbi romanin “Nëna”, Ombra GVG

**GRAZIA DELEDDA NË SHQIP.
NJË NGJARJE LETRARE.**

Nga Ermira Ymeraj (fq. 20)



FABIO M. ROCCHI Cilët janë zërat e parë të italofonisë shqiptare

Bisedoi Andreas Dushi

(fq. 2)

Është ajo çka jam përpjekur të bëj në librin *Le prime voci dell'italofonia albanese*. Libri është në proces përkthimi në gjuhën shqipe nën kujdesin e Prof. Diana Kastrati. Në këtë studim, kam tentuar të periodizoj fenomenin italoфон shqiptar në mënyrë që të vihet rregull mbi të gjitha në debatin kritik, i cili, në fillim të viteve Dymijë, është zhvilluar në Itali dhe në SHBA mbi të ashtuquajturën *letteratura dell'altro*.

Biri i njeriut

RENÉ MAGRITTE

Dr. Bledar Kurti

(fq. 22)



LIBRAT E JETËS SIME

ELIF SHAFAK

**Libri që nuk arrita ta
përfundoja: "2666" i
Roberto Bolaño-s.**

(fq. 19)

BIBLIOTEKË

Liridon Mulaj (fq. 15)

Provinca

Agron Tufa (fq. 21)

Shtatë tregime

Murat Aliaj (fq. 19)

Mani në bregore

**DUKE KUJTUAR POETIN
NDOC GJETJA...**

Nga Xhahid Bushati

(fq. 7)

**ÇËSHTJE TË NATYRËS
DHE FUNKSIONIT
TË LETËRSISË**

Nga Esmë Dodaj

(fq. 8)

**FATOS ARAPI DHE NJË
MEMORIAL POETIK PËR
HOLOKAUSTIN**

Nga Alisa Velaj

(fq. 14)

FABIO M. ROCCHI

CILËT JANË ZËRAT E PARË TË ITALOFONISË SHQIPTARE

Bisedoi Andreas Dushi

Fabio, ju prej kohësh keni vendosur të jetoni në Tiranë, ndonëse keni lindur në Itali. Cila ishte arsyeja e parë pse ju erdhët në Shqipëri e mandej, pse zgjodhët Tiranën si vendbanimin tuaj të përhershëm?

Mirë se të gjeta Andreas, është një kënaqësi për mua të bisedoj me ju. Dëshiroj në radhë të parë t'ju falenderoj për vëmendjen me të cilën i jeni përqasur librave të mi. Kam ardhur në Shqipëri për arsye pune në vitin 2014 dhe që atëherë nuk jam larguar më. Për një periudhë relativisht të gjatë të jetës sime, plot trembëdhjetë vite, kam punuar në webmarketing, një fushë totalisht e ndryshme nga ajo e studimeve që kam kryer. Prej vitit 2019 i jam rikthyer studimeve, aktivitet që për arsye ekonomike m'u desh ta ndërprisja në vitin 2006, menjëherë pasi kisha përfunduar doktoraturën. Në atë kohë isha akoma në Siena dhe profesori im, Romano Luperini, nuk arriti të më mundësonte një hyrje të menjëhershme në universitet, ndaj, për fatin tim të keq, m'u desh të ndryshoja rrugë. Por, sapo situata malejoi, i riktheva me entuziazëm studimeve dhe botës së mësimdhënies. Përsa i përket Tiranës, kam jetuar gjithmonë këtu. Fatkeqësisht, deri më sot e kam eksploruar pak vendin që më mikpret, por në kryqytet më duket se jam ambientuar mirë. Për mua është realisht një shtëpi e dytë.

Fusha juaj e studimit, ku jeni lauruar prej njëzet vjetësh në Universitetin e Pizës është Letërsia Moderne. Ndërkohë, rëndësi të veçantë i keni kushtuar letërsisë shqipe me një sërë artikujsh e studimesh me rëndësi të veçantë. Çfarë ju shtyu t'i përkushtoheshit pikërisht letërsisë së kësaj gjuhe, cili tipar apo element i veçantë?

Keni shumë të drejtë që nënvizoni faktin që formimi im, në një fazë të parë, është ndërtuar mbi kanonin e autorëve modernë dhe bashkëkohorë të letërsisë italiane. Kam studiuar dhe kam shkruar mbi veprat e Ippolito Nievo, Federigo Tozzi dhe sidomos Paolo Volponi. Por, kur i riktheva studimeve, pas asaj ndërprerjeje që ju tregova më sipër, ndodhesha në Shqipëri. Prandaj, m'u duk e natyrshme të filloja nga një letërsi që nuk njihja dhe që mund të më ndihmonte në një farë mënyre të rimerrijta ritmin. Kadare përbën një moment të jashtëzakonshëm konfronti

dhe reflektimesh, edhe pse, për arsye të kompetencave të mia gjuhësore akoma të limituara, e kam lexuar të përkthyer në italisht, shpeshherë nga frëngjishtja. Më pas, shkova drejt autorëve italoфонë: këtu dëshiroja të ndalesha më tepër sepse dukuria italoфонë është pjesë e letërsisë italiane bashkëkohore dhe e gjejmë të cituar bollshëm në manualet e historiografisë kritike. Shkrimet të cilave iu referohen ia kam dedikuar kësaj enklave jashtëzakonisht të pasur shkrimtarësh që u shfaqën në skenën italiane në fillim të viteve dymijë dhe që akoma sot krijojnë vepra interesante.

Si dikush me formim të marrë nga kultura italiane dhe dëshirën që atë formim ta përdorë në të mirën

e kulturës shqiptare, si e shihni komunikimin mes dy kulturave tona?

Nuk e di nëse ju dakordësoni me këtë përshtypje timen, por ka akoma pak rrugë për t'u bërë për vendosjen e një dialogu real dhe produktiv mes dy kulturave. Vendet tona ndodhen afër dhe kanë marrëdhënie politike e tregtare të konsiderueshme. Por, në aspektin kulturor, më duket se – edhe për shkak të një gjuhe të vështirë për t'u penetruar si shqipja – duhen kryer akoma disa hapa përpara që i konsideroj të rëndësishëm. Me pak fjalë, do të më pëlqente që në anën italiane të arrihej të flitej për atë që njihet, pa u bazuar në paragjykime apo fraza të shtirura, pa përdorur atë ndjesinë e pashprehur të superioritetit. Nuk



honeps paternalizmin e disa studiuesve të cilët pretendojnë ta likuidojnë çështjen shqiptare me dy rreshta në librat e tyre; demonstrojnë që kanë lexuar shumë pak dhe që nuk njohin autorët, veprat, tendencat dhe kronologjinë. Në të njëjtën mënyrë, më iriton sipërfaqësia që mbizotëron veçanërisht në dimensionin online, ku shpeshherë skena sundohet nga improvizimi. Protagonistët më autentikë të qarqeve letrare shqiptare – në gjuhën amtare, si italoфонë apo shkrimtarë në një gjuhë tjetër të huaj – kanë bërë prej kohësh një hap vendimtar: të çliroheshin nga një lloj provincializmi që i detyronte të luanin një rol mbështetës, gati dytësor krahasuar me eksponentë të kulturave që konsideroheshin më prestigjioze apo thjesht më të strukturuar. Mendoj se kjo lloj sjelljeje, e motivuar nga shkaqet e veta historike, duhet të çrrënjohet tashmë totalisht – atje ku ekziston akoma – mbi të gjitha për arsye se vjen nga një fazë e tejkaluar. Meqenëse jemi në këtë pikë, më lejoni të korrigjoj një pjesë të pyetjes suaj: unë nuk e përdor edukimin tim për të mirën e kulturës shqiptare. Unë përfitoj nga kultura shqiptare si çështje studimore. Thelloj, sipas një metode, për sa janë mundësitë e mia, një seri tekstesh që i perceptoj ekstrovertë dhe që në disa raste më magjepsin. Këtë e bëj duke u përpjekur të sjell një kontribut original atje ku më duket se akoma mungon. Fakti që kam studiuar në universitete si ato të Pizës dhe Sienës nuk më jep asnjë avantazh nëse instrumentat e studimit që kam mësuar atje nuk i vë më pas në dispozicion të teksteve me një lloj sjelljeje në të cilin duhet të mbizotërojë gjithmonë kurioziteti. Në të njëjtën mënyrë, dhe me të njëjtën dëshirë për të kuptuar, nëpërmjet një autori të madh bashkëkohor si Mircea Cărtărescu po i afrohem, për shembull, kulturës rumune, pa e konsideruar atë inferiore apo superiore ndaj asaj italiane apo shqiptare dhe pa aplikuar në mënyrë jo origjinale dhe jo personale një etiketë të papërcaktuar ballkanike për të penetruar mekanizmat e shkrimit.

Duke qenë se disa shkrimtarë shqiptarë shkruajnë në italisht, mendoni ose vëreni ekzistencën e një kanoni letrar shqiptar në letërsinë italiane, pra disa tipare unike që përbashkojnë shkrimtarët shqiptarë të cilët shkruajnë në italisht?

Po, absolutisht, ekziston një zonë e letërsisë bashkëkohore italiane e banuar

nga shqiptarë që kanë shkruar romane dhe tregime shumë interesante në një gjuhë të adoptuar. Kanoni i letërsisë italofone shqiptare, akoma në ndërtim e sipër, numëron dhjetëra emra dhe një bibliografi kritike të pasur. Për pasojë, është e qartë që përpjekja fillestare e studiuesit duhet të kryhet në drejtim të rindërtimit të fenomenit nga ana historike duke përcaktuar në bazë të disa karakteristikave formale dhe tematike homogjene, një fushë brenda së cilës të vendosë një grup autorësh referimi. Është ajo çka jam përpjekur të bëj në librin *Le prime voci dell'italofonia albanese*, i botuar në kolanën universitare Proteo në shtatorin e vitit 2021, me shtëpinë botuese Artemide në Romë. Libri është në proces përkthimi në gjuhën shqipe nën kujdesin e Profesoreshë Diana Kastrati. Në këtë studim, kam tentuar të periodizoj fenomenin italoфон shqiptar në mënyrë që të vihet rregull mbi të gjitha në debatin kritik, i cili, në fillim të viteve Dymijë, është zhvilluar në Itali dhe në Shtetet e Bashkuara mbi të ashtuquajturën *letteratura dell'altro*. Konkretisht, isha përqëndruar në fazën fillestare të dukurisë, fazë e cila akoma sot ngelet një nga momentet më të frytshme të kësaj rryme, duke i dedikuar studime specifike veprave të tre shkrimtareve: Elvira Dones, Ornela Vorpsi dhe Anilda Ibrahim. Por, do të ishte reduktuese dhe e padrejtë të ndaleshim vetëm te këto tre emra. Edhe shkrimtare të tjerë meritojnë padyshim lexime dhe reflektime të thella: zëra si Ron Kubati, Darien Levani, Artur Spanjoll, Alketa Vako, Arben Dedja, Durim Taci e deri te Elvis Malaj dhe të tjerë, përfaqësojnë vazhdimësinë e një fenomeni, që, siç përmenda më sipër, ka rezistuar për një periudhë të gjatë kohore. Siç e dini, javën e ardhshme nis një rubrikë imja në *ExLibris* që i dedikohet pikërisht kësaj teme. Objektivi kryesor është të ndihmoj në njohjen e veprave të këtyre shkrimtarëve, duke iu dedikuar analiza dhe duke i vendosur në kontekste të përshtatshme referimi. Çfarë t'ju them, mezi po pres të filloj dialogun me lexuesit e kësaj reviste.

Italianofonët shqiptarë, të shumë për hir të së vërtetës, kanë shprehur një lloj "trishtimi" pse shqipja që aq shpesh është pasuruar nga italishtja (askush nuk thotë duarlarëse [dhe s'e di a ekziston si fjalë], të gjithë thonë lavaman) tani po merr shumë më shumë nga gjuha angleze. Për ju si italian që njihni gjuhën e kulturën shqiptare, gjendeni edhe po të mos doni si urë lidhëse mes vendlindjes e vendbanimit, çfarë do të thotë ky shqetësim?

Është një shqetësim që ndaj dhe une. Pyetja që ju shtroni përmban dy aspekte të rëndësishme për t'u trajtuar. Përveç problemit të huazimeve që ju e ngrini haptazi, ekziston dhe ai i varfërimit të gjuhëve në këtë moment tranzicioni historik që po jetojmë. Po filloj nga ky i fundit. Mendoj se procesi i thjeshtëzimit të gjuhës krahasuar me pasurinë e saj origjinale është një fenomen gjenerate i përbashkët për shumë vende. Më duket se mediat e reja, kryesisht rrjetet sociale dhe aplikacionet e mesazheve direkte, po luajnë një rol thelbësor në këtë drejtim duke e reduktuar shkëmbimin gjuhësor mes të rinjve në nivele infrastrukture elementare. Me kalimin e kohës, siç thoni edhe ju, huazimet nga gjuhë të tjera kanë ndryshuar cilësitë e shqipes. Këtë vit pata kënaqësinë të ndiqja studiuesin



dhe përkthyesin Meritan Spahija, në një konferencë të mbajtur në Departamentin e Gjuhës Italine në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Tiranës, ku aktualisht jap mësim si pedagog me kohë të pjesshme. Spahija, tekta prezantonte përkthimin monumental të *Ferrit* dantesk – një punë madhore që më ka bërë tepër përshtypje – fliste pikërisht për pasurinë reale të gjuhës shqiptare, një pasuri fatkeqësisht e lënë në harrësë dhe e panjohur nga shumica. Do të më pëlqente që kjo tendencë të përmysej dhe që – në mënyrë tërësisht natyrale – thjeshtë të riktheheshit të lexonit shqipen tuaj, duke filluar nga baballarët e letërsisë. Ismail Kadare, si askush tjetër, ka krijuar një modularitet të ri për gjuhën shqipe, duke grumbulluar në mënyrë origjinale dhe krijuese prapashtesa dhe parashtesa që ekzistonin, por që ende nuk kishin shpalosur potencialin e tyre të plotë shprehës. Po ju jap vetëm një shembull, ndër qindra që mund të bëheshin, të diskutuar në bibliografi dhe sipas këtij këndvështrimi shumë elokuent. Në *Dosja H.*, për disa banditë që zbulohen nga drita e hënës, atë natë veçanërisht e dukshme, gjejmë: "Për fatin e keq të banditëve, hënëzonte pak." A nuk ju duket e mrekullueshme kjo "hënëzonte"? Është një neoformacion që i jep një forcë të pabesueshme foljes, duke e bërë atë krejtësisht të re. Është një term që në italisht mund ta përkthejmë si *luneggiare*, një folje mbiemër që të çon drejt Leopardit dhe drejt madhësisë ndjellëse të poezisë hermetike. Duke studiuar shqipen kuptova sa shumë logjikë dhe në të njëjtën kohë sa bukuri ka kjo gjuhë. Bëhet fjalë vetëm për ta rizbuluar atë: në klasikët tuaj tashmë keni gjithçka, me avantazhin e lakmueshëm krahasuar me traditat e gjata letrare evropiane, që mund t'i konsideroni baballarët tuaj si autorë vërtet të kohëve të fundit, nëse jo bashkëkohorë.

Jeni edhe autor i një libri të botuar në Itali ku Shqipëria trajtohet nga një pikëpamje e veçantë, interesante... Në të shkuarën, shumë autorë i kanë kushtuar pjesë nga krijimtaria e tyre Shqipërisë kur kanë kaluar në të, mes të cilëve sigurisht Lord Bajroni mbetet më i njohur. Pra libri juaj është një vazhdim i denjë i historisë së Shqipërisë nënkuptuar nga veprat letrare të të huajve për të. Si lindi ky

libër dhe si u prit nga lexuesi italian? Ndonëse tani shqiptarët janë realitet konkret thujse në çdo qytet a fshat të Italisë, vijon të ketë interes për t'i njohur edhe më mirë ata nëpërmjet letërsisë të tnde?

Ndihem pak në siklet tekta vë re përgatitjen tuaj. Konstatoj që njihni edhe librin tim *La disputa sul raki*, publikuar nga Besa Editrice në vitin 2021. Nuk jam i bindur nëse ai libër mund të arrijë të përfshihet në traditën për të cilën ju flisni: më duket – pa asnjë lloj modestie të rremë – vetëm diçka e vogël nëpërmjet të cilës munda t'i jap zë dëshirës për të treguar disa eksperiencë që kam jetuar këtu. Bëhet fjalë për histori nëpërmjet të cilave kam dashur të përmbledh ngjarje që kam jetuar ndërkohë që njihja shqiptarët dhe italianët që jetonin prej kohësh në realitetin e Tiranës. Me atë rast, përmes një sërë tregimesh të shkurtra, u përpoqa të rrëfej disa aspekte të Shqipërisë bashkëkohore, pikërisht atë Shqipërinë që e kisha prekur që në vitin e ardhjes sime këtu, në 2014, por që nuk e gjeja në librat e të tjerëve. Operacioni në atë rast ishte pjesërisht provokues: mora një nga temat më të shpeshta në përfaqësimin letrar të këtij vendi, pikërisht hakmarrjen, dhe solla këtë tendencë antropologjike në aktualitetin e ditëve të stome, duke treguar sesi në realitet shqiptarët mund të rafinohej dhe përditësohen në përgjigjen ndaj një gabimi ose një abuzimi të pësuar. Libri në Itali shkoi mjaft mirë do të thoja. Kaloi shumë shpejt në ribotim dhe pati shumë komente e përshtypje në internet dhe në revista të specializuara. Shkrimi më prestigjioz është ndoshta ai që u shfaq në *Cattedrale*, observatori i zonës së Torinos mbi tregimin e shkurtër që shqyrton dhe komenton përmbledhjet më të mira kushtuar *short story* në Itali.

Po nëpërmjet letërsisë shqipe? Sot në Itali, sipas këndvështrimit tuaj, cili është vendi që letërsia shqipe zë?

Sot, sipas një fenomeni global tashmë të afirmuar dhe të vështirë për t'u kthyer mbrapsht, në Itali, ashtu si në vende të tjera, ka rëndësi vetëm tregu. Më lejo të shpjegojmë: që libri duhet të shitet në mënyrë që të lexohet dhe të arrijë

në këtë mënyrë funksionin social të letërsisë, është një fakt. Por më duket e dëmshme që sidomos nga fundi i viteve Tetëdhjetë e në vazhdim, në librari, ky konstatim në vetvete banal, përputhet me ndarje specifike që vendosin një lloj kundër-etikete në kopertinën e librit, kategorizime që përputhen me nëndarjen në zhanre letrarë. Në këtë mënyrë, njësoj si në repartet e një supermarketi, orientohen dhe përcaktohen në raftë të ndryshme zgjedhjet e lexuesit. Oferta e publikimeve është e gjerë dhe e drejtuar në lloje lehtësisht të identifikueshëm. *Il giallo*. Letërsia sentimentale apo erotike. Letërsia homoerotike. Biografia e vipave të së shkuarës dhe të së tashmes. Romani historik. Saga e brezave, vendi i përsosur për tema të përshtatshme për trillim, në të cilat ngjarjet familjare kryqëzohen me historinë e një kombi. *Drama* e krimi, që ka lulëzuar duke filluar nga bestsellers si *Gomorra* i Roberto Saviano dhe *Romanzo Criminale* i De Cataldo, të dy të publikuar në fillim të viteve Dymijë dhe të dy me një sukses të madh në publik, falë edhe realizimeve kinematografike. Në këtë skenar, letërsia shqipe në Itali nuk gjen shumë hapësirë. Shtëpitë botuese dhe redaktorët duket se kanë destinuar për të - sipas asaj që unë e konsideroj një forcim historik që duhet kapërcyer fuqishëm sidomos nga autorët - një lloj përhumbjeje në të cilën ekzotikja përzihet me kujtesën e së kaluarës komuniste. Janë tema që ishin të përshtatshme njëzet vjet më parë dhe që janë eksploruar dhe ezauruar mjaftueshëm. Besoj se për të fituar një vëmendje më të ndryshme dhe më të vetëdijshme, letërsia bashkëkohore shqipe tani duhet të mendojë vetëm për veten, të flasë për të tashmen, për atë që është bërë kjo shoqëri, duke u mbështetur mbi të gjitha në përkthimet e mira, në të cilat ndjeshmërisë së përkthyesve amtarë i përgjigjet një kapacitet real gjuhësor që është në gjendje të menaxhojë kalimin nga teksti shqip në italisht.

Dhe së fundmi, projektet tuaja për të ardhmen, në fushën e studimeve letrare, cilat janë?

Po punoj mbi një libër kritik dedikuar figurës së Paolo Volponit. Do të botohet në Itali në vitin 2023. Volponi ishte mik i ngushtë i Pasolinit dhe përfaqëson më së miri atë brez shkrimtarësh e intelektualësh aktivë në vitet Shtatëdhjetë në Itali. Në këtë libër analizoj një temë në veçanti, atë të raportit mes shkrimeve të Volponit dhe të imazheve të marra nga arti figurativ. Volponi, më tepër se kushdo tjetër, ka zhvilluar në tetë romanet e tij si dhe në tregimet e poezitë, një obsesion të vërtetë për ekphrasis, për vizionin piktorial të prezantuar në rrëfimtari me qëllime alegorike, duke i dhënë jetë disa kontaminimeve të denja për tu studiuar. Ndërsa, për sa i përket shkrimtarëve italoфонë me prejardhje shqiptare, në muajt e ardhshëm, siç përmenda më sipër, do të dedikohem shkrimit të artikujve që do të përbëjnë rubrikën *Udha e Dorës* e cila do të publikohet në këtë revistë çdo dy javë duke filluar nga muaji nëntor. Krahas mirënjohjes që ndjej ndaj Shtëpisë Botuese Onufri - që vendosi të më jepte këtë mundësi të mrekullueshme për t'u shprehur - ndjej edhe përgjegjësinë për t'u përballur me një temë komplekse, ende në zhvillim e sipër dhe e karakterizuar nga shumë zëra të ndryshëm. Do të bëj më të mirën, por do të jenë si gjithmonë lexuesit ata që do të gjykojnë pas njëfarë kohe nëse ky projekt ka dhënë një kontribut origjinal.

Vetë rrethanat jetësore dhe kërkesat artistike ndaj vetes, midis Ovidit dhe Kadaresë, si dy krijues gjenialë, kanë ngjashmëri interesante. Lidhur me ngjashmëritë, për nga përmbajtja apo frymëzimi në veprat letrare, Lasgush Poradeci thekson: "Që një poet tjetër, i çdo kohe qoftë të ketë bërë vargje të ngjashme me vargjet e mia, do të thotë se ai, kur ka shkruar këto vargje, ka pasur të njëjtin frymëzim d.m.th. ka pasur të njëjtën situatë shpirtërore si edhe unë". Nga leximet e dy veprave shikojmë se kemi të bëjmë me tekste që na paraqesin tematika të krahasueshme midis dy autorëve në veprat përkatëse, po kështu me grupe idesh, tematika, motive dhe mbi të gjitha topose vendore të mirëfillta.

Ovidi si një nga poetët botërorë më në zë që Dante Alighieri e ka radhitur të tretin ndër poetët e shquar të letërsisë antike greko-romake, dhe të katërtin pas Virgilit që e "zgjodhi" si shoqëruar të vet në Ferr, një nga temat më të preferuara ka lirinë si topos themelor të veprës së tij. Ky topos u trashëguar në letërsinë latine nga vepra "Prometeu i lidhur" i Eskilit. Një nga shkaqet më kryesore të përndjekjes dhe dëbimit të Ovidit në Tomi prej Augustit, ishte shpirti i tij i lirë për t'i quajtur dhunën dhe tiraninë me emrin e tyre të vërtetë në veprën e vet. Që në Librin e parë të "Metamorfozave" ai i çjerr maskën tiranisë për dhunën, korrupsionin dhe luftërat e pandërprera që u sillnin mjerim pa fund njerëzve të thjeshtë nën sundimin totalitarist të perandorit August. Ovidi duke aluduar me epokën e hekurit thekson:

Çdo kob shpërtheu me t'parën natë epokë
që më e dobët ishte; turpi, e vërteta
dhe drejtësia u zëvendësuan
me rrena, me dredhi dhe me pusi,
me dhunë dhe me lakmi të pasurisë.
...Dhe shfaqet lufta ku përleshën njerëzit
e që me dorë t'gjakosur i tund armët
kumbuese. Jeta shkante me grabitje ...

Këto tablo kaq të qarta të shprehura me guxim për të vërtetën e dhunuar të të drejtave njerëzore nuk mund të mos e egërsonin dhe tërësinë perandorin të merrte vendime të prera e të pamëshirëshme ndaj Ovidit duke e degdisur në Tomi pranë Skithisë ashtu si guximtarin legjendar Prometeu e shtyu furia e urrejtjes së verbër të Zeusit në shkëmbin e Kaukazit. Të njëjtat rrethana pas dymijë vjetëve përsëriteshin në diktaturën enveriste shqiptare ku dhuna kishte të njëjtën fytyrë, bile edhe më të egër, ku njerëzit e thjeshtë ashtu si dhe poetët e shkrimtarët që guxonin të shpreheshin lirshëm internoheshin, burgoseshin, pushkatoheshin ose edhe vareheshin në litar.

Por t'i kundërvihesh me romane asaj dhune duheshin aftësi gjeniale të sofistikua artistike, krejt origjinale, një strategji e taktikë buuese e përpunuar mirë, për një kohë të gjatë dhe me shumë kujdes, gjë që Kadareja arriti t'i realizojë mrekullisht. Duke i mbetur besnik lirisë së vetvetes autori nga ana artistike aludon përmes subjekteve alegoriko-historike.

Në vazhden e narracionit të "Don Kishotit" të Cervantesit që ishte mbështetur tek letërsia mesjetare kalorësiake e



“Pallati i ëndrrave” të Kadaresë dhe “Metamorfozat” e Ovidit: *vështrim krahasues*

Nga Ahmet MEHMETI



tipit të Amadisit të Galisë etj, në një ravim përmes absurdit të Tabir Sarajit/Pallatit të Ëndrrave, ndërton konstruktë që të kujtojnë rrathët e 'Ferrit' të Dantes. Vetë ky i fundit, për strukturën e kryeveprës së vet u mbështet tek vepra "Etika Nikomakea" e Aristotelit, sipas një strukture morale të radhitjes së mëkateve (shih Kënga XI e Ferrit ku Virgili i përgjigjet pyetjeve të Dantes duke i shpjeguar organizimin e këngës I). Shumë frutdhënës ka qenë edhe komunikimi me kulturën arabe që vinte nga Spanja e Alfonsit X Të Diturit, këtij mbreti dhe eruditi të shkëlqyer ku u përkthyen e u shpërndanë në disa gjuhë europiane hadithet e Muhamedit mbi Isranë dhe Miraxhin (udhëtimi në Ferr dhe Parajsë). Këto materiale ju vunë në përdorim Dantes nga Brunetto Latini. Nuk kishte ndërmjetës më të dobishëm për Danten se sa politikani dhe letrari i shquar i Firences guelfiste, mësuesi dhe miku i ngushtë i tij që kishte qenë ambasador në oborrin e Kastiljes. Vetë Brunetto Latini kishte shkruar poemën didaktiko-alegorike Il Tesoretto ku rrëfen një udhëtim nëpër mbretëritë e natyrës e ku takon pesonazhe alegorike, por që mbeti e paplotësuar, pedanteske dhe e ftohtë. E kundërta ndodhi me kryeveprën gjeniale të Dantes. Kujtojmë këtu ndihmesën e jashtëzakonshme të studjuesit spanjoll Miguel Asin Palacios mbi ndikimin arab në Komedinë Hyjnore të Dantes.

Në vijimësi të kryeveprave europiane struktura e romanit 'Pallati i Ëndrrave', në mënyrë krejt origjinale dhe gjeniale i përshtatet subjektit duke evokuar pikë për pikë realitetin e një ferri jo më virtual por konkret dhe aktual që ishte vetë Sigurimi i Shtetit diktatorial me rrathët/katet e tmerrshëm të Seleksionimit, Interpretimit dhe Arkivit.

Dante Alighieri, po të ishte gjallë, do ta karakterizonte qëllimin guximtar të romanit të Kadaresë me vargjet e famëshme:

“Liri shkon tue kërkue, gja aq e çmueshme “
si e di ai që për 'te s'i dhimbet jeta”.

Me romanin madhështor "Pallati i Ëndrrave", me groteskun e tij të mprehtë, Kadareja, nga njëra anë e mohoi totalisht të ashtuquajturin realizëm socialist, duke e goditur për vdekje në të pesë shtyllat e negrehinës së tij të shpifur, kurse nga ana tjetër i çorri maskën regjimit diktatorial të izolimit dhe shtypjes mizore të çdo lirie njerëzore, nëpërmjet armës më të egër të Sigurimit të Shtetit dhe aq të adhuruar nga partia shtet, në kulmin e sundimit të tyre.

Nga trashëgimia e letërsisë së lashtë pallazgo-heleno-latine Kadareja mori dhe përdori me talent dhe origjinalitet gjenial toposin e "pallatit të ëndërrave"/ "pallatit të gjumit" që na shpërfaqet në mënyrë të spikatur në letërsinë latine në Librin XI të veprës "Metamorfozat" të Ovidit.

Po nga "Metamorfozat" e Ovidit, dhe pikërisht nga Libri IV, kënga e Piramid dhe Thishës, dy të rinjve që duheshin dhe familjet nuk i lejonin e që nga kjo ata përfunduan tragjikisht, ka gjasë që Shekspiri të ketë marrë subjektin e dashurisë së Romeos e Zhulietës për veprën e famëshme të vet.

Toposi i vendbanimit të Gjunit në veprën "Metamorfozat" lidhet me një personifikim hyjnor. Gjumi përfytyrohet në poezinë greke më herët në "Iliadën" e Homerit (14.231-291, ku Hera, ekuivalente me Junon romake, i bën një kërkesë); ai përshkruhet si një burrë i ri kurse tek Ovidi si i moshuar dhe babai i ëndrrave. Ovidi e shtjellon personazhin me një trope të ndërlikuar duke i dhënë atij karakteristikat e personit të përgjumur, sikur të mbartëte dhe të vepronte nga një fuqi abstrakte; "përtaci" nuk është një paralajmërim se ai do të jetë i ngadalshëm


për të kryer urdhërin e Junos (të cilin e bën pa vonesë) por një projektion mbi veten të efektit të tij - të cilin edhe Irisi do të filloj ta vuaj (lajmëtarja dhe e besuara e Herës, simbolizonte ylberin që quhej si urë midis qiellit dhe tokës, midis perëndive dhe njerëzve; në poezitë e mëvonëshme paraqitej si nëna e Erosit). Ai banon pranë maleve të Cimerianëve, që në "Odisea" (11.14-19) ndodhet pranë hyrjes së Nëntokës (Skëterrës), i mbështjellë me mjegull dhe errësirë dhe i paarrtshëm për diellin; këtu rrjedh një përrua e lumit të nëntokës, Lete.

Pra toposi i Pallatit të Gjunit/Pallatit të Ëndërrës në Librin XI lidhet me mitin e "Kërkimit të Ceiksit", mbretit legjendar të Thesalisë, bashkëshortit të Alkionës. Kur ky po shkante në Delf për tu konsultuar me orakullin e Apolonit, u mbyt në det. Alkiona e dëshpëruar vrapoi në breg të detit dhe kur pa kufomën deshi të mbytej por perënditë të prekura nga kjo dashuri i shndërruan të dy në bajza. Popujt e vjetër me mitin e shndërrimit të njerëzve në zogj përpiqeshin të shpjegonin ngjashmërinë e klithmës së zogjve me britmat e përvaqshme të njerëzve.

Është shumë interesant krahasimi i tekstit/intertekstit midis dy autorëve tanë se si na e japin në vështrim të parë vendin/toposin dhe sëbashku me të edhe trishtimin e shkretinë e dy pallateve kobzinj të ëndrrave.

Tek "Metamorfozat" e Ovidit kemi:

"Një ylber nëpër qiell kërkonte pallatin nën re, shtëpinë mbretërore të Gjunit. Aty pranë vendbanimit të Cimerianëve është një shpellë në një vend të izoluar, të gjerë, mal konkav, shtëpi dhe vendqëndrim i Gjunit përtac ku Febi nuk mund të depërtojë kurrë me rrezet e tij as në lindje, as në mesditë dhe as në perëndim të diellit; mjegullat e përziera me errësirën dhe muzgun e dritës së dyshimtë ngrihen nga toka. Atje gjeli vigjilent nuk e thërret Aurorën me këngën e sqepit të tij me vathë, as qentë vigjilentë as patat me nuhatje më të mprehtë se qentë s'e thyejn heshtjen



Në regjistrat e botuar të Universitetit të Padovës me shënimet e shekullit XVI, është një listim "1567... Ioannes Busichio de Civitali Fori Iulii." Në këtë vit, më 6 prill, do të ketë bërë kërkesën për mbrotje të doktoraturës njëfarë Ioannes Busichio në Padovë. Mbi këtë temë dhe ca çështje të tjera që lidhen me Mesharin do të ndajmë për lexuesin e ExLibris një fragment nga libri *Tipografia shqiptare 1555–1912* që rishtazi është promovuar në Prishtinë e Tiranë. Kërkimi që trajton kryesisht problematikën e shtypshkronjave, tipshkronjave dhe alfabetëve shqiptare një pjesë të mirë të vëmendjes ia kushton edhe *Mesharit* të Gjon Buzukut. Më poshtë fragmenti për Buzukun:

Në gjurmë të Gjon Buzukut

Çështja e vendit ku është shtypur Meshari është trajtuar që në fillet e buzukologjisë. Që në nismë që ngritur hipoteza — me shumë bazë — se *Meshari* duhet të jetë shtypur në të njëjtin vend ku Buzuku kishte qenë duke vepruar si prift. Dhe kjo bazohej në atë që gjendet e shkruar në kolofonin e mbijetuar të librit,

Ata që e shtamponin kishin vështirësi të mëdha dhe nuk mund të dështonin në bërje të gabimeve, sepse unë s'kisha mundësi të jem mes tyre gjatë gjithë kohës. Duke udhëhequr me kishën, më duhej të ndihmoja në dyja vendet. (Pasthënia e Mesharit)

Ky bisk i tekstit është i rëndësishëm për të paktën dy arsye, e para sepse tregon se Buzuku shërbente në një kishë, duke na zbuluar kështu pak nga jeta e tij, dhe e dyta sepse dëshmonte se ajo kishë ndodhej diku jo shumë larg shtypshkronjës. Pra, vendi ku është shtypur *Meshari*, duhet të ketë qenë, në të njëjtin rajon me një kishë ku ka mundur të shërbente një prift shqiptar. Shënimet arkivore heshtin për Gjon Buzukun. Krej çka dihet për të vjen nga kolofoni ku vjen edhe fragmenti i mësipërm. Kishte punuar në libër nga 20 marsi 1554 deri më 5 janar 1555. Ishte bir i një Bdek Buzuku. Kaq dihet për të. Megjithëse studiuesit e parë kishin identifikuar ndikimi venecian të libri i Buzukut, ishte lënë e hapur mundësia që ky libër të jetë shtypur diku në Ballkanin Perëndimor, mbase diku në Shqipërinë e Veriut. Rrota, bazuar nga gegërishtja e librit, fillimisht kishte propozuar Shkodrën ose Obotin, por gjithsesi e shihte si çështje që duhej studiuar më tutje,

Mund të jet kenë shtypë edhe njëti [Shkodër]; por kësi shtegu po e lam me kaq, tue shpresue, se për së shpejti do t'a rmojm edhe ma këthellhtë çashtjen e shtypshkronjave, qi mund të gjindeshin aso here në veprim në kët rrethin t'onë. (Rrota 1930: 39)

Por, më pas, nga studimi i Filip Fishtës (shih kapitujt paraprak) në konsultim të ngushtë edhe me Justin Rotën, kishte dalur sheshit se në këto dy vende s'ka pasur në këtë periudhë shtypshkronjë (Fishta 1934: 565–71). Fishta kishte ngritur hipotezën se vend i shtypit të *Mesharit* ishte Durrësi (1935: 80–85). Propozim që nuk është ndjekur nga studies të tjerë. Jokli e mendonte veriun e Shqipërisë si vend shtypi, duke e lënë gjithashtu të hapur mundësinë te Shkodra, por përtej supozimeve konkludonte se "do të jetë me randësi dase për çashtjen e vendit se ku në XVI shekull kemi një shtypshkronjë shqipe..." (Jokli 1930: 153). Jokli, përmes ekspertizës nga paleografi Hans Hirsch e kishte gjetur se gërmat e Mesharit ishin gotike të Italisë së Veriut, dhe kishte vënë re edhe ndikimin venecian në gjuhën e përdorur nga Buzuku (1930: 152–3). Roques, në anën tjetër, për Venedikun si

NJË GJON BUZUK NGA FRIULI DOKTORANT NË PADOVË NË VITIN 1567

Nga Yll Rugova

vendit të shtypit ishte mjaft i prerë, megjithëse ai më sigurt i referohej Venedikut si zonë ndikimi sesa qytet i shtypit. Roques që kishte identifikuar edhe ndikimin kroat te gjuha e *Mesharit*, hipotezë që gjerësisht trajtohet e pranuar sot, veçanërisht pas studimeve të mëpasme nga Çabej e Camaj (cf. Ismajli 1995: 115–128). Edhe Jovan Tomić qysh në vitin 1930 te *Hylli i Dritës* kishte dhënë argumentet kundër shtypit të Mesharit diku në Shqipëri, apo edhe Ballkan dhe ishte i mendimit se *Meshari* mund të jetë shtypur diku në Napoli (Tomić 1930: 143–144).

Çështja është shoshitur shumë edhe nga gjuhëtarë e albanologë të tjerë në më shumë se një shekull prej se kanë nisur studimet mbi Buzukun. Mes tyre duhet veçuar Çabej në vitin 1955, në përvjetor 400 vjetorin e botimit të Mesharit, i cili me argumente shtesë ka përforcuar supozimet e Joklit dhe Roques, duke anuar kah Venediku si vend shtyp (Çabej 1955: 74–5). Për Çabejin Buzuku vinte nga rrethi i Tivarit e Ulqinit, kurse vetë vepra e tij ishte "fryt i një politike kishtarë" që ishte zhvulluar në "një krahinë periferike, kufitare të kishës së Romës, me një popullësi katolike-shqiptare e ortodokse-sllave." Sipas tij një mes i tillë mund të kishte qenë ai me arqipeshkvin e Tivarin Gjon Brunin (c. 1536–1571), i cili ishte "mbase bashkatdhetari i tij më i ngushtë" (Çabej 1988: 219). Edhe Camaj, bazuar në veçori gjuhësore, pajtohej se gjuha Buzukut duhej të vinte nga një zonë "visevet anë e kand përfaq të Liqenit të Shkodrës" dhe se



kishte "tipare gjuhësore veneciano-dalmatine" (Camaj 1959: 163). Duke aluduar për një influencë të Venedikut.

Dëshmi shtesë në mbështetje të Venedikut, kishte qenë edhe lloji i letrës së përdorur në libër. Roques me përvojën e tij mbi shtypin mesjetar, përmes filigraneve të letrës kishte lokalizuar prejardhjen e saj italiane. Për këtë ai u referohej katalogut të bërë me mjaft detaje nga Charles-Moïse Briquet (1839–1918), një studiues i historisë së letrës (1932: 12–4). Mbi këtë çështje Roques

e jep një paragraf të shkurtër, por të rëndësishëm,

Letra ka filigrane të ndryshme. Unë nuk e kam marrë parasysh filigranin nga letra e faqes së mbështjellësit (delja në rreth), e cila me siguri është shtuar më vonë; në brendi të vëllimit gjejmë një stemë (f. xliij, xlviij), e tjerakah mbase një fleur-de-lis [karanfil v.j.], por mbi të gjitha (f. 92, 95 etj) një sirenë, me bishtin e dyfishtë të përdredhur sipri, e gjitha në një rreth, e ngjashme me shembujt te Briquet. (Roques 1932: 12)

Ky përshkrim na ka nxitur të gjejmë edhe katalogët e Briquetit, të cilët ishin në katër vëllime me rreth 14 mijë filigrane të ndryshme. Aty, duke ndjekur shtegun e Roques, kemi gjetur edhe disa variacione të fleur-de-lis (Briquet 1907: 381–3), dhe disa variacione të sirenës (f. 684–5). Kurse për stemën që përmendet, pa ndonjë përshkrim më të detajuar e kishim të pamundur të shikonim më tutje; në katalogun e Briquet janë disa mijëra stema krejt të ndryshme nga njëra-tjetra (Briquet 1907). Filigranet me përshkrimet e mësipërme te Briqueti çojnë drejt Italisë dhe Francës (cf. Roques 1932: 14). Letër me filigrane të tilla gjejmë edhe në Venedik, njësoj siç gjejmë edhe në Lion, prandaj pa i parë vetë filigranet e letrës së *Mesharit*, do ta kemi të vështirë të bëjmë krahasime të sakta. Por, vlen të theksohet se fleur-de-lis ishte edhe simboli i familjes Giunta, kurse sirena me dy bishta të përdredhur ishte simboli i shtypshkronjës së Rabanit. Me aq sa patëm mundësi të kërkonim, nuk gjetëm të dhëna nëse këto punëtori prodhonin edhe letrën e tyre, por, nëse po, kjo na përputhet shumë mirë edhe me gjetjet e kapitullit paraprak në lidhje me shtypshkronjën e *Mesharit*. Me çështjen e llojit të letrës është marrë edhe Martin Camaj, i cili kishte rënë në përfundim se ajo ishte prodhuar në rajonin e njohur për këtë industri, në Fabriano (Neziri 2008: 67). Kjo pjesë e Italisë është mes Venedikut dhe Romës, dhe mund të ketë furnizuar gjithë rajonin me letër.

Puna e historianes italiane, Lucia Nadin, me *Shqipëria e rigjetur*, duke trajtuar çështjen e inicialeve, megjithëse mbase nuk vjen nga fusha imediate e studimeve të saj primare, ka sjellë rezultate konkrete në definimin më të saktë të vendit ku ka mundur të jetë shtypur *Meshari*. Por, Nadin ka dhënë edhe propozime me interes sa i përket emrit të Gjon Buzukut në regjistrat italiane të kohës. Te Rrota për shembull, në shënimin e tij nga viti 1930, jepet forma Busuchu për mbiemrin e Buzukut nga regjistri në arkivat e Vatikanit (Rrota 1930: 31). Së fundmi përmes Demirajt ka marrë vëmendje edhe shkrimi i Nikollë Ketës nga viti 1777 për Buzukun, ku përveç tjerash jep edhe disa variante të mundshme të këtij mbiemri "...nga ku edhe kompozita tjetër Busecco, Bosichia, Buzuku, ose të jetë "buzë ujku", thënë ndryshe Bisulca" (Demiraj 2008a: 102–3). Nadin i propozon edhe format tjera si Busulchi, Busulchus, Busichio, Bosichio, Bosichio, Buxichio (Nadin 2012: 230–325).

Duke dalë pak jashtë magisteries tonë që gjithsesi është më e fokusuar nga tipografia; kemi parë mundësinë e kërkimit përmes OCR-së në burime primare të kohës, siç kemi bërë më parë edhe për identifikimin e inicialeve. I kemi provuar këta emra në librat e periudhës 1500–1600 si pikënisje. Dhe rezultatet ishin interesante. Nga format Busuchu, Buzuchu, Busulchi, Busulchus, Busichio, Bosichio, Busichius, Busichi, Bosichio, Buxichio, kemi gjetur të dhëna vetëm për Busichio, Busichi ose Busichius. Dhe me këtë mbiemër kryesisht kemi gjetur të dhëna të stratotëve dhe të epirotëve.



“NË KLUBIN E TË SHËMTUARVE”

Letërsia shqipe, sidomos në fushën e prozës, u është nënshtruar disa rrethanave e rregullave kushtëzuese etike, nacionale, politike, të një shoqërie që lëngon nga shumë telashe, teksa poezia sikur i ka kapërcyer paksa këto turbullira ku jeton shoqëria, në tehun e së kaluarës që është në ndeshje të pashmangshme me të tashmen.

Këtë kapërcyell të mundimshëm Gëzim Aliu e paraqet me mjeshtri në romanin e tij “Në klubin e të shëmtuarve”. Ky roman, i botuar në vitin 2009 dhe ribotuar pas dhjetë vjetësh, më 2019, i vlerësuar nga lexuesit dhe nga kritika letrare, thyen paradokset e krijuara apo më mirë marrëzitë që shfaqen si trillime të panevojshme në jetën shoqërore nga disa shkrimtarë të prozës. Rendi i krijuar shoqëror në roman, është e vërteta e kamotshme në sjelljet dhe përditshmërinë e njeriut apo qenies homosapiens.

Pa u futur në shqyrtimin letrar apo paradigmat gjuhësore që janë trajtuar nga njohësit e kësaj fushe më parë lidhur me këtë roman, “Në klubin e të shëmtuarve” përmban guximin e autorit për të shfaqur ecejaket e njeriut, moralin dhe amoralitetin që ka zanafillë biblike, e që e bëjnë njeriun të fantazojë në realizimin e epsheve të shthurura, sikur për të plotësuar mendimet e Frojdit dhe për të menduar se shoqëria përpos normave të saj, është e përbërë edhe nga fshehtësitë që, aq sa mund të quhen pjella imagjinative, ato, në kreshtat e saj janë më se të pranishme në shoqëri p.sh., incesti që e gjejmë edhe te tragjeditë greke, por edhe te trajtesat shkencore në fushën e kriminologjisë dhe penologjisë.

Kur flasim për varësinë e njeriut edhe si qenie, edhe si vetëdije, i orientuar në kohë dhe hapësirë, Aliu me lehtësi e përshkruan gjendjen faktike, siç shprehen juristët, por që nga fryma, nëse do të kalonte në censurë, libri do të merrte notën e surrealizmit, do të kritikohet për shpërthim ndjenjash, por që në realitet njeriu jeton me këto doke dhe manifestime, i cili herë pas herë thyen norma shoqërore për të provuar prekjet, komplekset e marrëzisë, shpërfaqjen erotike apo siç thuhet në Kosovë, bëhet “njeri i dalun fare”. Këtë jetësim të vërtetë, kryepersonazhi i Aliut e rrëfen në vetën e parë, në një rrugëtim nga koha kur ai fillon të mbajë mend, kur jetonte në familjen e madhe në katund, nën një çati me axhallarët dhe kur gjumi i fëmijëve bëhej bashkë me prindër në një dhomë jo më të madhe se gjashtëmbëdhjetë metra katrorë dhe kur shfaqja e “burrërisë” bëhej kur gruaja shqiptare

ROMANET E GËZIM ALIUT

Nga Mërgim BEKTESHI



trajtohej edhe me dajak e në këtë pështjellim nuk mungojnë as belatë me fqinjët, as incesti, masturbimi, përpëlitjet instinktive erotike, ndjenja që mund të duken edhe të shëmtuara.

Në këtë perceptim të romanit lindin mëdyshjet e lexuesit lidhur me mendjen e personazhit kryesor, se a kemi të bëjmë me tabula rasa apo me mendimin epistemologjik. Nga përvoja empirike gjejmë tendosjen e autorit për të shprehur pakënaqësinë funksionale të personazhit, tendencat e tij për të ndrydhur epshet dhe funksionet e tjera shtazarake, për të përqaftuar rendin shoqëror, rendin e neveritshëm që provokohet sa nga intuita epistemologjike aq nga mësimet e të parëve që e rrëshqasin në tabula rasa. Kur personazhi fillon të vizitojë “Klubin”, autori ia nisë ta bëjë leximin pak më të vështirë, duke nxjerr në pah mendimin filozofik për raportet mes të bukurës dhe të shëmtuarës, për jetëgjatësinë e njëjës dhe për fundin e tjetrës. Kjo vërtetësi dhe logjikë është më e ngatërruar se pjesa tjetër kur autori flet për “Kishte ardhur fundi i lirisë sime” (f.55), një pavarësi e personazhit duke ecur shkallëve të pasigurta, por që e ndjellin me lezet.

Pjesa më e vështirë e romanit është dalja nga “Klubin”, sepse hyrja në të është më se e lehtë, kur autori me zhdërvjelltësi artistike të tërheq për të kuptuar të shëmtuarën, peshën e vërtetë të saj kohore. Rrëfimi sa ngjan me fantastiken, ndër të tjera, mund të thuhet se është edhe alegori për kontrollin shoqëror të një grupi, që lufton të sundojë mbi të bukurën. Në tërë këtë rrafsh personazhi hamendësohet, nuk arrin të jetë vetvetja, sa i ndikuar nga bukuria që e kërkon që nga fëmijëria, aq më tepër kur mosha e pjekurisë e tërheq si fusha e gravitetit drejt përplasjes në të shëmtuarën. Ky tip i realizimit të romanit shquhet për autentiken, sepse është vetë jeta që kemi kaluar, kush më shumë e kush më pak ndër këto horizonte dhe ku secili mund të gjejë dromca të vetvetes e jetës së vet.

mendime mbi të bukurën. Një sinkroni në mes të artistëve për të përjetësuar vlerat e artit, të mbetura pezull nga ana e piktorit. I pari është prozator i letrave, ndërsa i dyti piktor që përmes ngjyrave në pëlhurën e tij mundohet ta rrezatojë brishtësinë e së bukurës, por kur mendon se vlera e artit po i venitet, përmes prozës mundohet të plotësojë finesat, dashurinë, ankthin, që nuk arrin t’i modifikojë me ngjyrat e tij apo siç e ndeshim një shprehje: “Pikturoje ti mungesën.” (f. 44). Piktura nuk arrin ta paraqesë mungesën a gjëra të kësaj natyre, vërehet një dorëzim i piktorit, që dromit ndërgjegjen në përpjekje për të gjetur ngushëllimin te proza.

Katedralja e autorit nuk është një ndërtesë skolastike, e as vend ku kryhen sakramentet, është pa simbolikën e shenjtë, kryqin, ku romakët, me apo pa vetëdije, e gozhduan Jezusin. Por, çfarë personifikon kjo Katedrale pa kryq? Nuk mund të jetë pyetje laike dhe as përgjigja nuk do të gjendet në provat rrethanore, sepse është mudi i autorit që çështjen ta shtrojë në themelësi, në të bukurën që gjendet brenda mureve të ndërtesës së madhërishtme të artit. Në veçanti piktori tjetëron këtë katedrale në imagjinatën e tij, ajo duket fine, ndërtesë pa dritare dhe dyer, ka mungesë të ikonave kishtarë e kryqit, aty është vetëm një pikturë, ajo e Mona Lizës së tij. I rreshtuar për lutjet shpirtërore, vdekja dhe marrëzitë mbahen larg në këtë roman, pra Thanatosi ngrihet plotësisht, injorohet deri në pafundësi.

Ashtu siç janë prozatorët që mallëngjehen apo u vjen muza nga veprat e paraardhësve, ta zëmë që nga grekët e lashtë e më vonë dhe që pastaj krijojnë originalitetin në krijimet e tyre, edhe piktorët zënë në thua dhe rrëzohen po me të njëjtin imagjinatë te Da



“KATEDRALJA PA KRYQ” DHE SHTATË DITË BIBLIKE


Letërsia është univers që kërkon mund për t’ia zënë fillin, në krahasim me leximin e ligjeve apo ndonjë ekuacioni matematikor, që kanë një rrjedhë më të qartë se ku dëshiron të arrih me to e përmes tyre. Proza romanore është më e vështirë të krijohet dhe të jetë e kapshme, e qartë, e këndshme për lexuesin, sepse po munguan këto, ajo krijon bezdi për të, pa dashje ai kërkon ditë më të mira që të vazhdojë me shfletimin e leximin e një romani të caktuar. Dhe mund të ndodhë që edhe pas tentativës së dytë, libri nuk lexohet, mbetet me pluhurin e dhomës, renditur në raft librash.

“Katedralja pa kryq” është roman nga autori Gëzim Aliu, prozator dhe studiues i letërsisë dhe në vijimësinë e romaneve të tij “Në klubin e të shëmtuarve” dhe “Gosti në natën e parë të vjeshtës”, qëndron në mes dhe mendoj se të tre romanet paraqesin trilogji. Nëse në “Klub” e gjejmë të shëmtuarën, “Katedralja pa kryq” shëmbëllen me të bukurën, teksa në “Gosti” shfaqet smira, një përndjellje e mallkuar midis botës artistike, për të urreyer të bukurën dhe të shëmtuarën njëherazi.

Në vitin 2014, “Katedralja pa kryq” pa dritën e botimit, një histori e veçantë, jo e dëgjuar më parë, dy protagonistë që flasin, shkëmbejnë korrespondenca,

GËZIM ALIU

KATEDRALJA PA KRYQ



B

Vinçi. Në këtë kontekst, protagonistin Leonard Kurti, i pasionuar pas të bukurës që i ngjizet në damarët e trupit e shpirtit, krijon një konglomerat në pëlhurë, i mbërthyer pas erosit, për të prodhuar një pikurë që ngjan me Mona Lizën, por nuk është Mona Liza, është një trajtë më e ndryshme, më e spikatur, që prodhohet nga bashkëdyzimi, nga prekja erotike, kontakti fizik, vuajtja e dashurisë, meditimet. Liza e pëlhurës së tij endet edhe në qytetin e piktorit.

Takimi i dy artistëve, prozatorit G. Aliu dhe piktorit L. Kurti, (për të cilin mund të themi se është një alter ego autoriale), në fillim duket se ka një ngërç, i pari është hezitues, edhe për takimin, edhe për veprat e tij, pikurat, edhe më shumë heziton për shkrimet, fillimisht nuk i lexon me aq dëshirë. Por, mes atyre teksteve të shkapërderdhura, prozatori arrin ta kuptojë vuajtjen e piktorit për të bukurën, ngjalljen e epsheve, dashurinë që dhemb, që personifikohen me femrat që ngjallin vëmendje të veçantë, dhe me kulminacionin, Mona Lizën. Përmes afërsisë e miqësisë të prozatorit dhe piktorit krijohet një rend i ri për të mbrojtur të bukurën, krijimet sa të imagjinatës, aq edhe të racionale e reales. Në këtë komunikim, edhe filozofik, do të hasim edhe diakroninë, pastaj dualizmin në mes të materies dhe idesë. Piktori vë në pah babanë e tij që besonte në pafundësinë e universit në rrafshin idealist, se ekziston Zoti dhe vëllanë që mbështetet në të arriturat shkencore. Në këtë mes piktori mundohet të portretizojë veten, bashkë me pyetjen se ku gjendet e bukura? Ai do të gjendet aty qoftë me Zotin apo Satanën. E bukura ia thyen gjithë vertebrat, ai gati lë në harresë edhe jetën e përditshme familjare, përkujdesjen ndaj gruas dhe vajzës së sëmurë.

Këtë vuajtje e ndien edhe prozatori, sepse jo moti kishte bërë një tregim për Mona Lizën, e cila sipas piktorit ekzistonte realisht, dhe posa kishte filluar komunikimet me të, ishte ngjizur një energji që nuk e linte të shkëputej nga kureshtja për ikonën e vetme në katedrale, kureshtja i thellohet edhe më shumë kur arrin në atelienë e tij. Atëherë piktori, me zhdërvjelltësinë e një finoku, arrin t'ia prezantojë shtatë pikurat, shtatë të bukurat, shtatë femrat e veçanta që lidhen me ditët e krijimit biblik. Secila pikurë në pëlhurë paraqet ditën e veçantë të krijimit që Hyu bëri. Por, tani prozatori e kupton se arritja deri tek ikona e vetme në katedrale paraqet vështirësi, piktori kishte arritur të krijonte universin e vet përmes shtatë pikturave ashtu siç kishte bërë Zoti në krijimin e universit.

Pra, momentet e sikletshme të "Katedralja" janë kur prozatori ndeshet me pikurat, të shtatat, pikura ku secila përbën një ditë kritike në krijimin e universit. Paraqitja erotike e tyre nuk është e rastësishme, sepse krijimi pa dashuri nuk është krijim. Është shija e thellë e artistit që shpalos me kujdes ditët e krijimit që përfaqësohen nga shtatë femra të bukura. E para ishte gruaja e tij e bukur, që ia rriste fëmijën dhe kujdesej për punët e shtëpisë, por ndrojtja e saj gjatë pikturimit, piktorit ia kishte pamundësuar të përqendrohej aq sa duhej në ngjyrat e tij, ia kishte pamundësuar vazhdimin e krijimit. Por, dita e parë është shpërthimi, big-bengu i madh si dhe frika e madhe e piktorit se nuk po arrinte ta plotësonte veprën e vet siç mendonte. Ndoshta edhe Zoti pati frikë për projektin e tij...

Dita e dytë, pra pikura e dytë, vjen me një vetëbesim, si për krijuesin artistik, ashtu edhe për Hyun, dhe kështu vazhdon deri në ditën e shtatë, kur pushon Krijuesi, por jo edhe artisti: "Zoti pushoi në ditën e shtatë, e vërtetë, tha ai, por, unë nuk jam Zoti, apo jo?", shprehet piktori (f. 98). Pështet artistike e të shtatë pikturave është boshti i fabulës kryesore të këtij romani, pa harruar se ato janë në atelienë e piktorit, brenda katedrales së autorit.

Në këtë këndvështrim, qasja dhe mënyrat që ka përzgjedhur Gëzim Aliu për ta krijuar këtë roman, edhe duke e pasur parasysh këndvështrimin letrar-gjuhësor, që e kanë diskutuar studiues të tjerë, përbëhet edhe nga metoda e komunikimit në mes të dy artistëve, që është e thellë dhe kërkon kujdes në lexim. Në fakt, ky roman të bën për vete, por gjatë leximit përjetohen magjepsje që kërkojnë vëmendje ndaj gjërave që shprehen, sepse është komunikim i



artistëve dhe jo komunikim i përditshëm. Ky roman dhe romanet e tjera të Gëzim Aliut kanë sjellë novacione në letërsinë shqipe, tema më ndryshe seç jemi mësuar t'i dëgjojmë dhe t'i lexojmë.

NJË TABLO PËR MASKARADËN

Gëzim Aliu, në vitin 2017, u ka dhënë lexuesve një roman krejt më ndryshe nga ajo që jemi mësuar të lexojmë kohëve të fundit nga krijimtaria letrare shqiptare. Romani "Gosti në natën e parë të vjeshtës" (Parnas, 2017), pos tjerash, shpërfaq artistikisht falsitetin dhe mediokritetin e 'artistëve' xhelozë e smirëzinj, teksa në prezantime imagjinare reflektojnë një lartësi qytetërimi të rremë.

Në këtë roman, në qendër është një gosti interesante që zhvillohet brenda disa orëve në shtëpinë e Cen dhe Anita Berishës. Të ftuarit "shkëlqejnë" nga stili perëndimor, me veshje të ndryshme, pamje, qëndrime e mendime. Autori me mjeshtri dhe si me 'metër' u bën përshkrime personazheve duke përkufizuar çdo detaj. Hamendjet, sorollatjet, bisedat, llafet, qeshjet, grindjet, thashethemet brenda kësaj shtëpie me formë arkitektonike të veçantë, paraqesin ndeshjen e dukjes perëndimore me hapësirën e ngushtë, edhe mendore

e shpirtërore. Është një përpjekje për përqafimin e qytetërimit perëndimor, pas daljes nga lufta. Por, mysafirët e pispillosur e tradhtojnë vetveten shpesh dhe mospërputhjet mes shfaqjes dhe brendisë së tyre, e neveritin Cen Berishën.

Ndërkaq, ka një ngjallje më relative në përshkrimin psikologjik të mysafirëve që herë pas here Cenit i ngjajnë me fantazma. Autori kryesisht vëren përplasje të qytetërimeve dhe mundohet t'i pikturojë në një tablo sa më saktë, por duke mos harruar përkufizimin freudian, i cili, sado që duket jo shumë bindës për psikologët e tjerë, ndër përsiatjet tona gjendet në ndër dije dhe pluskon në mendjet tona. Ndeshemi me seksualitet dhe shpërthurje të vetëdijes drejt qëllimeve finale, ndrydhje që janë të panevojshme në shumë situata, që domosdo autori i përshkruan ashtu siç mund të ngjajnë në jetën shoqërore. Këto cytje për të ndrydhur dhe ruajtur kontrollin normativ të shoqërisë duke u thirrur në etikën e brishtë të krijuar mes njeriut dhe qenies së tij si homosapiens, shpesh janë të meta që e tradhtojnë edhe njeriun më të ndritur të kohës.

Tabloja që krijon Gëzim Aliu ngjan me një maskaradë të cilën, përmes personazhit, e shndërron në një vështrim më të përveçëm për secilin mysafir veç e veç. Mysafirët, edhe pse nuk mbajnë maska, kanë maskat shpirtërore që fshehin identitetin neurotik përmes arteve pamore e të tjera, duke rrëfyer krijimin që në masë të madhe, aq sa e bezdisin autorin, e bezdisin edhe personazhin, Cen Berishën.

Guximi i autorit shfaqet edhe kur flitet për dorëshkrimin e Cen Berishës, që pulson të vërtetat që i shfaqen atij në ankthin për ngjarjet e paraluftës, luftës dhe të pasluftës, për heronjtë e vërtetë dhe ata të cilët i shërbyen me të vërtetë atdheut, dhe në anën tjetër, disa skenarë të shkurtër që mëtohen të bëhen filma, që nxjerrin në pah edhe dallaveraxhinj e bashkëpunëtorë të pushtuesit që lartësohen më vonë në shoqërinë kosovare. Kjo është pjesa më kulmore e romanit që të largon për një kohë nga trillet e mysafirëve, nga ajo maskaradë dhe shpërfaq vullnetin e Cen Berishës të djegë dorëshkrimin e tij apo të shkrihet e të humbë në tablonë e gjendjes aktuale, që e trishton dhe mbi themelet e së cilës bëhen përpjekje të ndërtohet një rregull i ri shoqëror.

Gëzim Aliu na ka dhënë një roman bashkëkohor, që duhet të lexohet pa ndërprerë për ta kuptuar situatën e ritmin e orëve të gostisë, roman me kompozicion atraktiv, duke mos të bezdisur në asnjë sekondë të vetme. Edhe ato detajet e meskinitetit kanë porosi në vete, po ashtu gjuha e lirë erotike e largon lexuesin nga monotonja, nga etika e panevojshme që shfaqet në libra të tjerë duke përdorur fjali të zëvendësueshme nga anatomia e njeriut dhe që zbeh trajtën e vërtetë aktuale gjuhësore.

Ky roman është për gjendjen e rëndë, të trishtueshme, është për "originalitetin" e individit dhe të shoqërisë sonë, për të fshehtat e një maskarade të përditshme, që duhet të zhvishet nga petku i marrëzisë e Gëzim Aliu e bën këtë me mjeshtri.



Në tetorin e vitit 2013, përmbledhja me poezi të zgjedhura "Më jepni një emër" e poetit Fatos Arapi, botohej në gjuhën polake nga shtëpia botuese "Komograf" në Varshavë. Poezitë u përkthyen nga Mazllum Saneja dhe Eva Smietanska, ndërsa libri u shoqërua me një parathënie të Andrzej Zaniewski-t, poet, prozator dhe kritik shumë i njohur në Poloni e përtej saj. Përveç faktit kuptimplotë, se ky vëllim i tij në polonisht përbën një njohje të poezisë sonë elitare në një tjetër gjuhë evropiane; përtej rastësisë fatlume se vjen i botuar në tetor, muaj, të cilit poeti i këndoi si rrallëkush në poezinë shqipe dhe në të cilin biri i Akrokerauneve nisi fluturimin e tij qiellor; ky vëllim me poezi, përmban një nga studimet më të përkora dhe të thella që i është bërë ndonjëherë poetikës arapiane nga kritika e huaj dhe ajo shqiptare. Në parathënien e librit, me titullin intrigues "Emra të shkëmbinjeve që shkëlqejnë në gji", Zaniewski e vë theksin në shumë aspekte të krijimtarisë së poetit shqiptar, por ne do të ndalemi në dy prej tyre: së pari, në përfundimin se: "...nga poezitë e Fatos Arapit aq shumë kam mësuar për Shqipërinë dhe Shqiptarët" dhe së dyti, (por jo nga rëndësia), në përcaktimin shterues se: "...dy forca, dy vektorë të qartë etikë vigjiluan mbi djalosin nga deti Jon, duke e shpënë atë në thellësitat e fatit. Kjo një energji e pashtrësme e Jetës dhe një nevojë e pamposhtur e Lirisë".

Që të mësosh nga një poet apo shkrihtar i përkthyer në një gjuhë të caktuar, për fatin e kombit të tij, është padyshim privilegj, jo vetëm i talentit të përveçëm poetik (truall letrar ku shumë janë të thirrur dhe fare pak të zgjedhurit), por edhe një mision i shenjtë shpirtëror për ta mbartur atdheun kudo me vete, si Atlasi qiellin e tij. Është padyshim kjo lloj mbartjeje e atdheut dhe nevoja e pamposhtur e lirisë, një ndër shumë arsytet që do ta kenë shpënë kolegun tjetër ballkanas të Fatosit tonë, pikërisht poetin dhe studiuesin maqedonas Anté Popovski, që të arrijë në gjykimin se: "Poezia e Fatos Arapit është vertikalia estetike dhe morale e poezisë bashkëkohore shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX". Vertikalja morale e poezisë së Arapit, vjen me faktin se poeti nuk i këndoi vetëm lirisë dhe jolirisë së atdheut të tij në epokën e ndryshme, por se nocionin liri ai e pa në shumë dimensione, ku njëra prej tyre ishte **liria e popujve**. Gjatë krijimtarisë së shtrirë në gjashtë dekada, poeti eci dorë për dore me tragjeditë e shumë popujve, u këndoi himne lirie tiranive të qytetërimeve të lashta dhe atyre moderne. Qe si një lloj ushtari i rrëzuar në fushën e betejave të pakohshme për liri, ku hordhitë e çmendura të bijve të errësirës ngjishnin hapat e tyre të komanduar prej frymës së ndotur të tiranëve.¹

*"Po unë vij e mbledh rrënojat,
dhe me duar të dhimbjes sime
asgjësimin
ngre në këmbë.*

*Mu në zemër të njeriut
ngrita shtatoren e dhimbjes."
(Exegi monumentum)*

Poeti i ngre një shtatore dhimbje edhe holokaustit nazist në vende të ndryshme të Evropës. Pjesa dërrmuese e poezive për tragjedinë e popullit hebre dhe popujve të tjerë janë përfshirë në përmbledhjen poetike në gjuhën polake. Janë poezi të mrekullueshme si nga ana estetike, ashtu dhe nga intensiteti i pikëllimës pa cak e zanafillë përpara rrënojave të humanizmit njerëzor. Përmendim poezitë "Dahau" dhe

¹ Në vitin 1997, në vëllimin "Gloria Victis" të Arapit gjyjmë poezinë "Më frymë tiranësh ndoten fatet e mia".

FATOS ARAPI DHE NJË MEMORIAL POETIK PËR HOLOKAUSTIN

Nga Alisa Velaj

"Dedikim në ditarin e Ana Frankut" në vëllimin "Drejt qindra shekujsh shkojmë" (1977), "Më duhet të takoj Robert Desno-n" në vëllimin "Më duhet një gjysmë ëndrrë" (1999), "Përse të shkosh në Mat'hausen?" në vëllimin "Shëtitje pa veten" (2005) etj. Shohim se dy poezitë e para vijnë të botuara gjatë viteve të diktaturës, ndërsa dy të tjerat në kohën e pluralizmit politik në Shqipëri.

Nga të dhënat historike, mësojmë se Dahau ishte i pari kamp përqendrimi i hapur nga udhëheqja naziste në mars të vitit 1933 dhe shërbeu si model për ndërtimin kampeve të tjera të përqendrimit në Gjermani. Sipas të dhënave të kampit, puna në Dahau ishte aq rraskapitëse, sa viktimat e para humbën jetën tragjikisht në tri javët e para, ndërsa deri në përfundimin e luftës, aty gjetën vdekjen rreth 32 000 të burgosur. Kampi i Dahaut është pra i pari varr masiv i holokaustit hebre të kohëve moderne. E keqja e parë, që do të mbillte të tjerë varre apo varri mëmë. Prandaj

dhe Arapi e përfytyron Dahau si një varr shëtitës.

*"Nga dita në ditë,
nga viti në vit. Varr që ecën
udhëton, Dahau."* (Dahau)

Çfarë e pikëllon poetin tonë përtej ndodhisë së tmerrshme? Padyshim se e keqja që ka zënë rrënjë dhe papritmas nuk vjen në përfytyrimin e një varri të ngulitur në një tokë, por si një varr shtegtar që mund të shfaqet papritur në horizontet e një tjetër populli. Ecën e udhëton njeriu, por jo varri i tij. Një varr udhëtar papritur do të ngjallet dikur diku dhe do të gëlltisë të tjerë njerëz. Një varr udhëtar tregon se apeli për humanizëm nuk ka nevojë vetëm për fjalë, por për veprim që e ç'rrenjosin të keqen me themel. A nuk u shfaq ky varr shëtitës në Ukrainën e sotme, ku mijëra jëtë të pafajshme u gllabëruan prej ditës në ditë? Poezitë që Arapi i thur holokaustit hebre marrin vlerë edhe për holokaustet e



tjerë që kemi përpara syve. A nuk tingëllon poezia "Dedikim në ditarin e Ana Frankut" si një vaj për një vajzë të vogël ukrainase nëse do ta hiqim emrin e Anës dhe do ta zëvendësojmë me emrat Alona, Antonina, Maryna, Mikhaila? Tek emri i Anës fundosen gjithë tragjeditë njerëzore, të kohëve të shkuara dhe të kohëve të tashme, të kohëve të lashta dhe të kohëve moderne. Edhe poeti shqiptar që i shkruan këto vargje ka gjithashtu një varr ende të pazbuluar në maktet dhe në shpirtin e tij: varrin e të vëllait, Vllasit, kujtimi i të cilit dhe i mijëra të vrarëve të tjerë, i të zhdukurve pa nam e nishan apo i të burgosurve politikë në burgjet e atdheut, e bën që ta ndiejë dhimbjen e popullit hebre, njësoj si dhimbjen e tij. Ndaj flet për varre të gjalla që enden në kujtesën e njeriut si fantazma ndjellakeqe.

*"Ka një emër të thjeshtë gjer në dhimbje...
E merr në duar, e kundron...e së largu
ndjen se si tek ty gjithë tragjeditë
njerëzore
fundosen e kridhen...
Një emër njeriu - Ana Franku."* (Dedikim në ditarin e Ana Frankut)

Në qytetin e dashurisë, në Paris, Arapi nuk mundet ta gjejë dot udhën për te dashuria e tij, pa iu përfalor së pari Robert Desnos. Robert Desnos (1900-1945) është poet i shquar surrealist francez. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Desnos ishte anëtar i Rrjetit Francez të Rezistencës dhe botonte shkrime me pseudonime të ndryshme, derisa ra në sy të Gestapos dhe u arrestua më 22 shkurt 1944. Vuajti dënimin në kampet gjermane të përqendrimit në Aushvic, Buchenwald dhe në fund në Terezín, ku edhe vdiq nga ethet e tifos një muaj pas çlirimit të kampit. U shua në Malá pevnost, pjesë e brendshme e Terezínit, e cila përdorej vetëm për të burgosurit politikë. Si mundet dikush të mos humbasë një Paris të tërë, një dashuri të tërë në Paris, nëse i shmanget takimit me poetin profet të Lirisë dhe dashurisë? Si mundet Arapi të jetë i lirë për të shijuar Parisin dhe dashurinë, nëse më parë nuk bekohet prej këngëtarit të dritës Robert Desno, i cili u përpoq për një Paris pa pranga tiranie, për një qytet pa hije vdekjeje nëpër shpirtat e njerëzve. Prandaj shpirti i poetit shqiptar është i paqetë në qytetin e dritave, i paplotë derisa ende s'ka takuar Prometeun e Lirisë.

Më duhet të takoj Robert Desno-n, në Paris.

Ai është i vdekur, as unë s'jam i gjallë.


.....

Ai është hije, as unë s'jam i vërtetë.

.....

*Tani më duhet prej territ tim,
të krijoj e ta ndez diellin.*

*Dhe me diellin tim në dorë,
të hyj në jetën e Saj. (Më duhet të takoj
Robert Desno-n)*



Fatos Arapi (djathtas) me të vëllanë Astritin, më 25 dhjetor 1942, në gjermadhat e shtëpisë së djegur nga pushtuesit fashistë italianë. (Botohet për herë të parë.)

Libri që jam duke lexuar

Po rilexoj "Mendja e robëruar" e Czesław Miłosz-it. Poeti dhe eseisti polak shkroi shumë për mërgimin, atdheun, përkatësinë, kujtesën, historinë, autoritarizmin... Duke ardhur nga një vend si Turqia, që është një vend i amnezisë kolektive, e kam lexuar gjithmonë Miłosz-in me një ndjenjë afrie dhe miqësie.

Libri që më ndryshoi jetën

Orlando i Virginia Woolf-it. Isha studente kur e lexova për herë të parë. M'u duk sikur zbulova një kontinent të ri. Orlando është një histori e shumë shpërndërtimeve dhe udhëtimeve magjepsëse. Është univers i i paqëndrueshëm. Duke guxuar të shkoj përtej të gjitha kufijve – kulturës, gjeografisë, kohës, gjiniisë, lindjes/perëndimit, të shkuarës/të ardhmes – Orlando më dha atë që mund ta japë vetëm letërsia e mirë: një ndjenjë të vërtetë lirie.

Libri që do të doja ta kisha shkruar

Projekti i harqeve prej xhami mbi rrugica i Walter Benjamin-it. Të ecësh përgjatë gjithë atyre rrugëve, të shikosh një qytet dhe njerëzit e tij të ndryshëm, të jesh një flâneur (shëtitës) i vërtetë, që vëzhgon modernitetin me të gjitha iluzionet dhe premtimet e tij të pambajtura... Më pëlqen Walter Benjamin-i. Është mendimtar i jashtëzakonshëm, një rebel i vetmuar që nuk i përshtatet asnjë grupi etnik, njeri me intelekt të madh dhe ndoshta me dëshpërim më të madh, dhe sipas fjalëve të Hannah Arendt-it, "një mistik i dështuar". E admiroj për të gjitha këto.

Libri që ka ndikuar më shumë tek unë

Kaq shumë libra dhe përralla popullore kanë ndikuar. Më pëlqen të krijoj një urë lidhëse midis kulturës së shkruar dhe botës së përrallave të rrëfyera me gojë; midis historive të Lindjes së Mesme dhe kanonit perëndimor. Një mijë e një netë pa dyshim kanë ndikuar tek shkrimet e mia, me stilin dhe strukturën e tyre lojcake që lejon tregimin e rrëfenjave brenda historive. Gjithashtu, Odisea e Homerit. Udhëtimi i kthimit pasi ka ndryshuar gjithçka: jo vetëm rruga dhe heroi, por dhe destinacioni, por siç na krijojnë ndjesia edhe ne, ka ndryshuar edhe rrëfimtari.

Libri që mendoj se është më i nënvlerësuar

Motra e huaj, e Audre Lorde. Sigurisht që nuk u nënvlerësua kur u botua, por është harruar gati plotësisht nga brezat e rinj. Askush



nuk shkruan si Lorde për lidhjen me motrave, guximin dhe qëndresën.

Libri që më ndryshoi mendjen

Ura mbi Drina e Ivo Andriqit. Isha shumë e re kur e lexova për herë të parë dhe deri atëherë, e vetmja histori që dija ishte versioni

nacionalist, zyrtar që mësohej në shkollë. Kisha mësuar se ne otomanët kishim qenë një perandori e fuqishme që kishte sjellë drejtësi e qytetërim kudo që kishin vajtur. Megjithatë, leximi i Andriqit më bëri të kuptoj se si ndryshon historia në varësi të asaj se kush e tregon atë.



Libri i fundit që më bëri të qaj

Çdo libër nga James Baldwin. Emocionohem edhe kur ia dëgjoj zërin, kur dëgjoj bisedat dhe intervistat e tij. Baldwin-i është i shtrenjtë për mua.

Libri i fundit që më bëri të qesh

Çdo gjë nga David Sedaris-i më bën gjithmonë të qesh, dhe është lloji i humorit që nuk i shikon njerëzit nga lart, por i përfaqon qeniet njerëzore me të gjitha të metat dhe marrëzitë e tyre.

Libri që nuk arrita ta përfundoja

2666 i Roberto Bolaño-s. Dhe ky është një autor për të cilin kam shumë respekt. Por nuk e di se çfarë ndodhi me 2666. Mund të provoj përsëri. Kam një ndjesi faji.

Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar

Interpretimi i ëndrrave i Sigmund Frojdit. Në njëfarë mënyre s'mund ta lexoja, ndoshta edhe kjo është krejt frojdiane!

Libri që mund të jap si dhuratë

Amatori nga Thomas Page McBee. Ose Murmurima e Will Eaves-it.

Libri i parë që mbaj mend e kam lexuar

Unë kam lindur në Strasburg, Francë, në një shtëpi plot me emigrantë dhe studentë të majtë ku zakonisht lexonin Louis Althusser-in në një mjedis të mbytur nga tymi i cigares. Pasi prindërit e mi u ndanë, nëna më çoi në Ankara, Turqi. Ishte një lagje shumë konservatore, kishte pemë qershie në oborret e shtëpisë... Ishte një kohë dhune politike me bomba në rrugë, kështu që s'mund të dilje e të luaje jashtë. Uleshja pranë dritares dhe lexoja për orë të tëra: Gra të vogla të Louisa May Alcott-it, Rrëfenja për dy qytete të Dikensit, Konti i Monte Kristos... histori që nuk kishin të bënin me jetën që jetoja dhe megjithatë personazhet ishin shoqëruarit e mi.

Leximet për qejf

Librat e gatimit! Meqenëse ka shumë detaje të kuzhinës, shije dhe aroma në letërsinë time, shumë lexues hamendësojnë se duhet të jem një kuzhinierë e hatashme. Për fat të keq, nuk jam, por më pëlqen të lexoj libra gatimi.

Përktheu Granit Zela

*Arti ndjell një mister pa të cilin
bota nuk do të ekzistonte.*
René Magritte

Vepra *Biri i Njeriut* (1964) është piktura më e njohur e artistit belg René Magritte (1898-1967). Figura e burrit të veshur me pallto të zezë, me kapele republike, me një mollë që pluskon përpara fytyrës së tij, është ndër më të njohurat dhe më të përdorurat në ilustrime, reklama, media, etj, edhe në ditët e sotme.

Në pamje të parë, shikuesi ngryset vetullat dhe ndien një vërshim mendimesh të cilat nuk ndalen gjëkund, e nuk kapen dot pas ndonjë kuptimi. Shikuesi dallon njeriun, mollën, murin, qiellin dhe detin, të cilat janë mëse të qarta në vetvete, por të pikturuara bashkë e të kompozuar në mënyrë të tillë, ato trazojnë imagjinatën dhe të shtyjnë thellë në kthinat e thella të perceptimit.

Kjo pikturë është provokuese. Dhe ky ishte pikërisht qëllimi i artistit: të provokonte dhe sfidonte perceptimin njerëzor mbi figurat dhe objektet e zakonshme, e për t'i shpalosur ato në kompleksitetin e përbërjes së tyre. René Magritte krijoi një numër të shumtë imazhesh të mprehta e mendim-provokuese, duke pikturuar objekte të zakonshme në një kontekst të pazakontë. Veprat e tij shquhen për sfidimin e perceptimeve të paramenduara që shikuesit kanë mbi realitetin.

Teksa shohim *Biri i Njeriut*, mendja nis e na jep mesazhe se në të ka diçka që nuk shkon, dhe sytë mundohen që ta gjejnë se ku qëndron anomalia. Mendja nis e vihet në konflikt me sytë. Ajo percepton figurën e burrit në tërësi ndërsa sytë fokusohen te molla e cila ngulitet gjithnjë e më shumë në mendje edhe nëse e hedhim vështrimin diku tjetër.

Më pas, duke analizuar me imtësi çdo pjesë të tablosë vërejmë që bërryli i majtë i figurës është në drejtim të kundërt, pra duket sikur artisti e ka pikturuar anën e majtë të burrit me pamje nga deti e jo nga shikuesi. Ky dyjëzim imazhi i manifestuar në një figurë të vetme, na kujton Davidin e Michelangelo-s, i cili përfaqësonte në krahët e tij dy natyra: atë aktiven dhe pasiven. Por në rastin e *Biri i Njeriut*, dyjëzimi është shpalosur me pozicionimin, me frontalën dhe të pasmen, me pamjen nga shikuesi ose me pamjen nga horizonti, afrimin dhe arratinë. Dhe muri që gjendet pas burrit shton kontrastin midis izolimit dhe lirisë, kafazeve mendore dhe horizontit të përtejme.

Shohim që palltoja e burrit ka tre kopsa, por e treta është e pambërthyer. A është kjo e qëllimshme? Patjetër që po. Është një lojë pamore me shikuesin, duke e ftuar atë të përfshihet në tablo, ashtu siç bëri Caravaggio me shportën e frutave në skaj të tavolinës, e cila dukej sikurdo binte, duke ftuar shikuesin të zgjaste dorën e ta mbante.

Aspekti më tërheqës i imazhit është fytyra e njeriut e cila është e mbuluar nga një mollë e ndritshme jeshile me pesë

Biri i njeriut

NGA

RENÉ MAGRITTE

Dr. Bledar Kurti



gjethe. Vështirë të dallohet, megjithatë, Magritte e ka pikturuar syrin e majtë të njeriut duke vështruar përmes gjetheve.

Burri në tablo është vetë artisti. Magritte vishej në jetën e përditshme me kostum të zi dhe kapele republike, ndaj në këtë vepër ai e përdori mollën për të fshehur fytyrën e tij të vërtetë. Dhe në komentet e tij, po aq trilluese sa edhe vepra, në lidhje me pikturën, Magritte përmendi dëshirën njerëzore për të parë e zbuluar atë se çfarë fshihet prapa të dukshmes. Ai u mor vazhdimisht me konfliktin që mund të lindë midis "të dukshmes që është e fshehur dhe të dukshmes që është e pranishme", ndaj në këtë tablo shikuesi është kureshtar por dhe i frustruar me fytyrën që nuk mund të shihet për shkak të mollës. Ndaj atij i duhet të imagjinojë se si është fytyra. *Biri i Njeriut* është i thjeshtë por i habitshëm, i qartë por enigmatik. Njeriu me kostum e me fytyrën e tij të mbuluar, ka nxitur imagjinatën e miliona njerëzve.

Në lidhje me këtë pikturë, vetë Magritte u shpreh kështu:

Së paku fytyra fshihet pjesërisht. Kështu që ju keni fytyrën e dukshme, mollën, që fsheh të dukshmen por të fshehur, fytyrën e njeriut. Kjo është diçka që ndodh vazhdimisht. çdo gjë që shohim fsheh diçka tjetër, ne gjithmonë duam të shohim atë se çfarë fshihet nga ajo që shohim. Ka interes të madh për atë që është e fshehtë dhe për atë që e dukshmjia nuk na tregon. Ky interes mund të marrë formën e një ndjenje mjaft të fortë, një lloj konflikti, midis të dukshmes që është e fshehur dhe të dukshmes që është e pranishme.

Ajo çfarë e bën edhe më provokuese këtë tablo është titulli. *Biri i Njeriut* është një term që të çon përtej kohrave dhe koncepteve, e lidhet si me vetë njerëzimin ashtu edhe me hyjninë. Ky është një nga termat me të cilin Krishti i referohej vetes, ndaj dhe *Biri i Njeriut* gjendet 81 herë në greqisht në Dhjatën e Re të Biblës, ndërsa në hebraisht, në Dhjatën e Vjetër, mbi 100 herë, por duke iu referuar Adamit. Kësisoj, me termin *Biri i Njeriut* Krishti shpalli natyrën e tij hyjnore si bir i Perëndisë, por

njëkohësisht edhe atë njerëzore si bir e pasardhës i Adamit, njeriut të parë. Këtë natyrë të dybotshme, e cila gjendet në pothuajse të gjitha kryeveprat e botës, Magritte e ka manifestuar përmes misterit, provokimit të mendjes, dhe gjëzës së asaj që duket e asaj që fshihet.

Por edhe molla luan rolin e vet në këtë konceptim të dybotshëm. Lidhja midis përdorimit të mollës dhe titullit të pikturës është një referencë e qëllimshme ndaj tundimit të Adamit në Kopshtin e Edenit dhe si pasojë rënien e njerëzimit në mëkat. Edhe pse në Bibël, në librin e Zanafillës, nuk përmendet asnjëherë fjala mollë por vetëm fryt, për shkak të pikturave dhe ilustrimeve ndër shekuj mendja njerëzore e lidh mollën me frytin e pemës së ndaluar. Por, pas kësaj lidhje midis njeriut dhe hyjit, Adamit dhe Krishtit, njeriut modern dhe zanafillës së mëkatit, *Biri i Njeriut* i Magritte mund t'i referohet kujt do, madje edhe një njeriu pa fytyrë i veshur me kostum e me kapele republike, i cili mund të jetë artisti, por edhe vetë shikuesi.

Magritte ishte surealist. Artistët surealistë, të ndikuar nga psikologjia freudiane, u angazhuan me idenë se ka të vërteta që qëndrojnë nën sipërfaqen e gjërave. Për ta, forma nuk është krijuar për të kënaqur syrin, por për të stimuluar mendjen që të njohë veten dhe gamën e fshehtë të aktivitetit të saj. Në artin e surealistit, bota objektive refuzon të mbetet një realitet i ndarë, por bashkohet në mënyrë aktive me imagjinatën tonë për të shembur muret kufizuese të këtij mashtrimi të thjeshtë racional, duke e çliruar mendjen për të përfshirë botën e arsyes me kuptimet e veta komplekse. Si rrjedhojë, ne shohim me sy ndryshe e me një vështrim të freskët, mbi objektet e hapësirës dhe me një kuptim të ri mbi hapësirën e mistershme të mendjes sonë.

Pikturat e Magritte, në pjesën më të madhe, kanë një logjikë të pamëshirshme, aq të pamëshirshme sa që shkatërrojnë vetë logjikën duke treguar se sa i varfër është një element për të kuptuar si perceptimin shqisor ashtu edhe imazhet e mendjes. Çdo pikturë më vete e bën shikuesin të vetëdijshëm mbi problemin pamor, idenë iluzive, dhe mbi imazhin provokues që duket transparent dhe i thjeshtë, por mbetet problematik në vetvete. Më tej, ato na bëjnë të vetëdijshëm për habinë e spekulimeve të mendjes sonë dhe jo thjesht një realitet personal i fantazisë që i përket vetëm artistit.

"Arti i pikturës," shkroi Magritte në një nga letrat e tij, "konsiston në përfaqësimin me anë të teknikës pikturore të imazheve të paparashikuara që mund të më shfaqen në momente të caktuara, qoftë kur sytë e mi janë të hapura apo të mbyllura." Magritte kurrë nuk u përpoq t'i shërbente pikturës, por ai e përdori atë si një instrument të dijes dhe çlirimit. Pikturat e tij nuk kanë për qëllim zbavitjen e syrit, por të ndihmojnë njeriun të gjejë veten, të zbulojë botën dhe ta pasurojë atë. Në këtë mënyrë Magritte e përdori artin e tij si një mision me ndikim universal.

Arti i Magritte është zbulues e matur dhe reflektuese e një mendjeje të pjekur dhe të ndjeshme. Ai filloi të skiconte peizazhe dhe portrete qysh kur ishte adoleshent. Në vitet e para të jetës së tij ai pati një jetë të rehatshme, e i përkiste një familje të shtresës së mesme. Por kur ishte 13 vjeç, jeta e tij mori një kthesë tragjike nga vetëvrasja e nënës së tij. Ajo mbyti veten në një lumë të vogël dhe u gjet e veshur me rrobat e natës e me fundkëmishën e mëndafshhtë të lidhur mbi kokën dhe fytyrën e saj. Gjatë jetës së tij, Magritte pikturoi figura njerëzish me leckë apo çarçafë mbi kokat e tyre sikur po mbyten. Në mënyrë të ngjashme, në pikturat e tij vërehen shpesh dhe arkemorte dhe gurë varri. Madje edhe kostumi dhe kapelja republikës janë referenca për prindërit e tij, pasi i ati kishte qenë rrobaqepës ndërsa e ëma kapelebërëse.

Magritte jetoi tre vite në Paris. Pjesën më të madhe të jetës, si edhe gjatë pushtimit gjerman në Luftën e Dytë Botërore ai e kaloi në Belgjikë. Gjatë atyre viteve ai e siguroi jetesën duke kopjuar veprat e Pablo Picasso dhe Georges Braque. Aftësitë e tij artistike i mundësuan që të kopjonte e falsifikonte kartëmonedha për të shkaktuar inflacion në monedhë, me shpresën për të kërcënuar financat gjermane. Dhe kështu, në mënyrën e vet, ai kontribuoi në luftën anti-naziste.

René Magritte i qëndroi porsë një dishepull besnik Surrealizmit deri në fund të jetës. “Surrealizmi kërkon nga jeta jonë kur jemi zgjuar një liri të ngjashme me atë që kemi në ëndrrat tona,” u shpreh ai. Ndaj edhe përzierja midis iluzionit dhe realitetit ishte shtysa kryesore në artin e tij. Stili i tij unik vë në dyshim e sfidon sigurinë tonë mbi të vërtetën pamore. Ai pikturoi imazhe iluzioni dhe ëndrash. Veprat e tij janë enigmatike, e luajnë me dyshimet mbi të vërtetat pamore. Ai u shpreh se: “Njerëzit që kërkojnë kuptimin simbolik nuk arrijnë dot të kuptojnë poezinë dhe enigmën e trashëguar të një imazhi, imazhet duhen parë ashtu siç janë.” Teknika e tij ishte e saktë, e kujdesshme por edhe e rëndomtë. Ikonografikisht ai krijoi një repertor të imazheve që nguliten në mendje, të cilat shfaqen në mënyrë të përsëritur në mjedise të zakonshme, por të papërshtatshme. Nën frymën surrealiste tablotë e tij ishin si përgjigje për pyetjet e reja që vetë ato shtrinin.

Qëllimi parësor i Surrealizmit nuk ishte kurrë vërtetësia ndaj natyrës. Surrealistët synonin të arrinin “të vërtetën revolucionare”. Pikturat surrealiste tregojnë histori. Dhe në të gjitha veprat e Magritte ne arrijmë të bëhemi pjesë e shumë historive. Ai krijoi gjëza përmes komponentëve të realitetit, e gjatë procesit të krijimit ai theksonte absurditetin e tyre. Pikturat-gjëgjëzë të Magritte janë lojra intelektuale të cilat ndërkohë shtrojnë pikëpyetje mbi realitetin. Dhe ai e bëri këtë përmes elementeve tërësisht të veçantë, të paprecedentë dhe të pakrahasueshëm. E në këtë mënyrë ai e bën shikuesin të ndalojë e mendojë mbi natyrën e



realitetit, dhe mbi perceptimet tona të pashprehura me fjalë. Ai e zhvendos shikuesin nga gjërat e rëndomta duke ofruar surpriza, dhe këtë e arrin duke i transformuar tërësisht situatat e zakonshme reale. Loja e ndërthurjes midis poezisë dhe pikturës, subjektit dhe idesë, magjisë dhe pasqyrit, përshkruhet më së miri nga Magritte duke ia mohuar subjektit identitetin e tij real. Dhe këtë ai e realizonte edhe me fjalë, si në rastin e llullës - “Ceci n'est pas une pipe” (Kjo nuk është një llullë) te vepra *Tradhtia e Imazhit*, në të cilën ai pikturoi një llullë e poshtë saj shtoi nënshkrimin “Kjo nuk është një llullë,” duke luajtur me perceptimin e shikuesit e duke mohuar identitetin e objektit.

I pyetur për këtë lojë e trillim artistik, Magritte u shpreh kështu:

“Llulla e famshme. Sa shumë qortime kam marrë prej njerëzve për të! E megjithatë, a mund ta përdorni këtë llullë? Jo, është vetëm një përfaqësim, apo jo? Ndaj, nëse unë do kisha shkruar

në pikturën time “Kjo është një llullë”, do të kisha gënjyer!”

Mendja e dashuron të panjohurën, dhe shpirti i njeriut yshtet nga e paditura. Zemra e njeriut tërhiqet nga bukuria e mjegullës. Instinkti i njeriut i përgjigjet të përtejmes. Ndaj edhe Magritte krijoi imazhet më sfiduese për perceptimin njerëzor. Ato janë ftesë për një udhëtim drejt së panjohurës. Dhe, padyshim vepra *Biri i Njeriut* është një ndër imazhet më yshtëse dhe trilluese në historinë e artit. Ajo përmban mister, iluzion, gjëzë, dhe poezi.

Imazhet poetike dhe emblemat e misterit të Magritte shkonin përtej penelit të tij, ato ishin një stil jetese dhe filozofi mendimi. Në një letër drejtuar një mikut të tij ai shkruan:

Për mua, poezia nuk ka të bëjë me formën. Ajo ka nevojë për një formë. Ajo është një përshkrim i mendimit. Dhe ky përshkrim është një imazh i dukshëm. Mendimi që përshkruan i kthen të paditurës atë që dihet. Ka fuqinë për

t'i ngjasuar universit. Ndërsa esenca e imazhit poetik është e mistershme. Ajo i përgjigjet më së miri natyrës sonë për t'u tërhequr nga misteri.

Për Magritte poezia dhe imazhi ishin një. Dhe ai ka lënë shumë shënime mbi këtë bashkim, apo mbi forcën trilluese të artit në tërësi, por, ashtu si çdo artist tjetër në histori, rrallë komentoi për veprat e tij në mënyrë shpjeguese, duke respektuar rregullin e artit se artisti është vetëm një ndërmjetës midis veprës dhe shikuesit.

Nëse do i kërkohej Mozartit që të përshkruante me fjalë simfonitë e tij askush nuk do i dëgjonte ato. Apo nëse Shekspiri do tregonte me gojë historinë e Hamletit, askush nuk do merrte kohën për ta lexuar. Jo vetëm muzika dhe letërsia, por edhe piktura hyn tek zhanrat që duhen përjetuar, ndaj edhe vetë krijuesit e veprave nuk janë shumë të zellshëm për t'i interpretuar ato. Ata kërkojnë që të jetë vetë tabloja ajo që flet sa një mijë fjalë, e ata të qëndrojnë të heshtur, pa spekuluar verbalisht me vetëdije, por me përlulje ndaj forcës komunikuese të artit, i cili e bën çdo shikues ta përjetojë atë në mënyrë unike. Ndaj nëse një mijë njerëz qëndrojnë përpara një tabloje të vetme, atëherë do ndizen një mijë emocione, secila e veçantë dhe unike.

Arti ka një buzëqeshje të personalizuar për gjithësecilin prej nesh, dhe një çelës për këdo nga ne, që hap çdo derë të mendjes sonë, duke na zbuluar mistere të cilat janë të rezervuara vetëm për sytë tanë.

Biri i Njeriut është Adami, Krishti, artisti, unë, ti, e në fakt e gjithë historia e mbarë njerëzimit, që nga Kopshti i Edenit e deri në ditët e sotme moderne, një histori krijimi, rënie, privimi, shpagimi, dhe vetëdije për universin brenda dhe jashtë nesh, për universin e artit i cili na shpalos përgjatë epokave fytyrat e tij të shumta, përmes së cilave ne arrijmë të kuptojmë më mirë veten.



LIRIDON
MULAJ

Provinca

Onufri

